



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0217

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “H & B – Consulting” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-185-5-1-1, me 19/05/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “H & B – Consulting” SH.P.K. me nr. 2025/0217, e datës 02/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-185-5-1-1.
2. Vërtetohet B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të aktiviteti të prokurimit nga AK – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 18.12.2024 “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-185-5-1-1. Më datën 13.03.2025 ka publikuar raportin e vlerësimit të tenderve OE “Linda; Vali Invest SHPK & B-Bardhi”

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2,686,642.55 €.

Me 18.03.2025, “H & B – Consulting” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 25.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “H & B – Consulting” SH.P.K. me nr. 2025/0175 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me nr. të prokurimit 206-24-185-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “H & B – Consulting” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

H&B Consulting Sh.P.K, më datë 18.03.2025, paraqet kërkesën për rishqyrtim duke paraqitur të gjitha faktet dhe argumentet lidhur me njoftimin e AK. AK më datë 25.03.2025, e refuzon kërkesën për rishqyrtim, duke shkelë në mënyrë flagrante dispozitat e lartcekura të LPP-së. AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së, për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke shkelur edhe nenin 38 dhe 40 par.4 dhe par.8 të rregullores Nr.001/2022, për PP, pasi që AK për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar nga OE H&B Consulting Sh.P.K, që të sqaroj tenderin e tij sipas nenit 38 të kësaj rregullore, për më tepër arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me dispozitivin e tij dhe në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të operatorit Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe atë:

Neni 1: Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve – AK ka vepruar në kundërshtim me këtë nen pasi që ekzaminim, vlerësimin dhe krahاسimin e tenderëve e ka bërë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, pasi që fare nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë dhe real të ofertës së operatorit Ekonomik H&B Consulting, por ofertën e tij e ka refuzuar pa asnjë bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Gjithashtu AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka vepruar në kundërshtim me Nenin 60 LPP-së Kriteri për Dhënien e Kontratës, duke e eliminuar operatorin ekonomik H&B Consulting Sh.P.K përkundër faktit se i njëjti është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Po ashtu AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka vepruar në kundërshtim me Neni 69 të LPP-së, pasi që operatori ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, i ka përmbushur të gjitha aftësitë teknike dhe profesionale sipas dosjes së tenderit dhe Operatori ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, i ka ofruar të gjitha dëshmitë për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Në arsyetimin e vendimit të goditur me këtë ankesë, sa i përket Pretendimit ankimor 1, AK-ja ka konstatuar si vijon:

Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, konsideron se AK-ja, në vendimin e goditur me këtë ankesë arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me diapozitivin e tij pasi që sa i përket pretendimit ankimor të parë, ka konsideruar se pretendimi ankimor i joni është pjesërisht i bazuar, por për komisionin vlerësues nuk ka qenë e pranueshme kjo dëshmi, pasi që nuk figuron emri i projektit. Ky arsyetim sa i përket pretendimit të parë ankimor është qartazi në kundërshtim me diapozitivin e vendimit si dhe me dosjen e tenderit. Pasi që vet AK-ja ka konstatuar që pretendimi është pjesërisht i bazuar pasi që përmbushet kushti prej së paku 500 mijë Euro, ndërsa

në dosjen e tenderit askund nuk ceket fakti që duhet te figuroj emri i projektit.

Për më tepër më poshtë po e bashkëngjisim edhe kërkesën 2 sipas dosjes së tenderit:

Pra nga sa u tha më lartë qartazi vërtetohet fakti se Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, e plotëson këtë kriter sipas dosjes së tenderi dhe kjo vërtetohet edhe nga konstatimi i AK, por që komisioni vlerësues në mënyrë tendencioze dhe në kundërshtim me Kërkesën 2 sipas dosjes së tenderit nuk e ka aprovuar këtë pretendim të AK-së, si të bazuar.

Për se u tha më lartë Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K ka dorëzuar një dokument bankar që dëshmon se Operatori Ekonomik (OE) ka mjete të gatshme në xhirollogari, duke përmbushur kështu njërin nga dy opsionet e parashtruara në kërkesën tuaj. Sipas kërkesës, dokumenti mund të përmbajë:

1. Dëshmi qe OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose
2. Dëshmi për qasje të pakushtëzuar në kredi në emër të projektit.

Në këtë rast, ne nuk kemi pasur kredi të dedikuar për këtë tender, por kemi përmbushur opsionin e parë të kërkesës duke dëshmuar mjetet e gatshme në xhirollogari. ndërsa kërkesa me emër të projektit sipas dosjes është kërkuar për në rast se OE nuk ka në dispozicion mjetet monetare dhe kërkon kredi nga institucioni bankar.

Andaj AK-ja, gabimisht kanë konstatuar se Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K nuk i kemi plotësuar pjesërisht këtë kërkesë, por që e njëjta është e pamjaftueshme sipas konstatimit të komisionit vlerësues, pasi që nga vërtetimi bankës BKT i datës 30.12.2024, me numër të protokollit 706-13050/24, e cila ka qenë e bashkangjitur si provë në momentin e aplikimit për këtë tender është vërtetuar se Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K në llogarinë bankare të kompanisë ka 660,757.70 EUR, pra shumë kjo që jo vetëm që e plotësin kushtin 2 por edhe e tejkalon kushtin e kërkuar sipas kërkesës 2 të dosjes së tenderit dhe nga ky vërtetim, kriteri i kërkuar me dosjen e tenderit është përmbushur në përpikëri dhe plotësisht.

Më poshtë po e bashkëngjisim vërtetimin e lartcekur.

Sa i përket prendimit të dytë: AK-ja ka konstatuar se prendimi jonë nuk është i bazuar, pasi që klomisoni ka konstatuar se janë tre fajle me të njëjtin emër “Deklaratat e dorëzuara në ATK për tre vitet e fundit”, por shkarkimi nga formati ZIP e ka ruajtur vetëm njërin prej tyre për shkak të emërimit të njëjtë.

Ky kosnatim i komisionit është qartai i pabazuar dhe tëndencioz, me të vetim qëllim eleiminimin e OE ankeues, pasi që Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, i ka bashkangjitur të tre këto deklarata tatimore në ATK dhe atë për vitin 2011-2022-2023, të kërkuara sipas kërkesës 1 të dosjes së tenderit dhe kjo vërtetohet edhe nga vet konstatimi i AK-së ku ka konstatuar se: Janë tre fajle me të njëjtin emër “Deklaratat e dorëzuara në ATK për tre vitet e fundit”, ndërsa pas shkarkimit të formatit ZIP e ka ruajtur vetëm njërin prej tyre për shkak të emërimit të njëjtë, pra në rastin konkret AK-ja është dashur që sipas neni 59.4 pika (i) apo (ii) të LPP-së, të sqaron këtë gabim teknik të bërë nga ana tyre.

Për më tepër pas shqyrtimit të dokumentacionit në kuadër të së drejtës sonë për qasje në dokumente, kemi vërejtur një shkelje të kërkesave të tenderit nga Operatori Ekonomik që është shpërblyer me kontratë.

Konkretisht, kemi konstatuar se mungojnë deklaratat tatimore për anëtarët e konsorciumit, përfshirë edhe liderin e tij.

Sipas kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit, është e detyrueshme që Operatori Ekonomik të dëshmojë qarkullimin vjetor për tre vitet e fundit (2021-2022-2023) me një vlerë jo më pak se pesë (5) milionë euro. Në rast të një grupi operatorësh ekonomikë, është përcaktuar se lideri i grupit duhet të kontribuojë me së paku 60% të qarkullimit të përgjithshëm.

Duke qenë se operatori i shpërblyer nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore për anëtarët e konsorciumit dhe liderin, ky fakt përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Duke u bazuar në argumentet e paraqitura më sipër dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) si dhe rregulloren përkatëse të prokurimit, kërkojmë që të anuloni vendimin për dhënien e kontratës dhe të rishikoni ofertën tonë si të vlefshme për shpërblyer me kontratë. Një veprim i tillë do të sigurojë mbrojtjen e interesit publik, shmangien e shpenzimeve të panevojshme dhe përdorimin e fondeve publike në mënyrë të drejtë dhe transparente.

Dhe në fund, AK nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Andaj mbi bazën e të lartcekurave japim këtë PROPOZIM:

Duke konsideruar që AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartshënuara të LPP-së, dhe akteve nënligjore, ku si pasojnë e shkeljeve të tilla ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga Operatorit Ekonomik H&B CONSULTING SH.P.K, si dhe dëmtimin e buxhetit të shtetit duke vendosur që me kontratë të shpërblehet operatori ekonomik me çmim shumë më të lartë, pasi që OE H&B Consulting Sh.P.K, i plotëson të gjitha kriteret për dhënien e kontratës.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 par 1 dhe 2 të LPP-së, Neni 6 të LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 të LPP-së Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, Neni 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Neni 60 të LPP-së Kriteri për Dhënien e Kontratës, Neni 69 të LPP-së, Neni 70 të LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 38 të Rregullores 001/2022 për PP, Neni 40 par 4 të Rregullores 001/2022 për PP, Neni 40 par 8 të Rregullores 001/2022 për PP Neni 48 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kërkojmë nga OSHP që të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim dhe këtë Ankesë dhe duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, barazisë dhe mos-diskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje, i propozojmë të sjell këtë: VENDIM të APROVOHET SI E BAZUAR, ANKESA e OE H&B CONSULTING SH.P.K, lidhur me tenderin “Ndërtimi i QKMF në Shtime”, i iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë. Dhe te ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues, i publikuar nga Ministria e Shëndetësisë, i datës 25.03.2025 dhe lënda kthehet në Ri-Vlerësim, dhe mos të dëmtohet buxheti në vlerë prej : 18,303.26 Ri-Vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat e LPP-së, dhe në kërkesat e dosjes së tenderit, e që realisht më pas do të duhej që FITUES të shpallej Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - 2.Përqjigja e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te oe H&B Consulting SH.P.K.:

Pretendimi i parë: Konsiderojmë se pjesërisht është i bazuar pretendimi juaj i parë ankimor rreth Vertetimit bankar nga BKT per mjete ne llogari, por per komisionin vleresues nuk ka qene e pranueshme kjo dëshmi duke u bazuar ne kerkesen e DT qe dokumenti bankar duhet te jete ne emer te projektit, ndersa ne vërtetimin tuaj nga BKT per mjetet ne llogari ne vleren 660,757.70 euro nuk figuron emri i projektit. Gjithashtu jo bindes ka qene edhe pershkrimi ne kete vertetim ku citohet se ky mund te perdoret vetem per qellime orientuese.

Pretendimi i dytë: Konsiderojme se nuk është i bazuar pretendimi juaj i dytë ankimor rreth Deklaratave Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK, per arsye se ne oferten e grupit te rekomanduar jane tre fajle me te njejtin emer “Deklaratat e dorezuara ne ATK per tre vitet e fundit” e te cilat jane te tre OE ofertues, por shkarkimit nga formati ZIP e ka ruajtuar vetem njerën prej tyre si duket per shkak te emertimit te njejte. Kjo vertetohet lehte meqense oferta e OE ne sistem ka ne permbajtje dokumentat si me poshte:

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 07.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0217/25, ndërsa me datë 17.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0217 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.-

-Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “H & B – Consulting” SH.P.K. - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0217 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërtimi i QKMF ne Shtime” me nr. të prokurimit: "206-24-185-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës Punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

AK me datë 13.03.2025 publikon njoftimin B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, duke rekomanduar për kontratë OE Linda; Vali Invest SHPK & B-Bardhi SHPK, ndërsa OE ankuesi

është eliminuar me arsyetimin:

Si e tillë, OE ankues i pakënaqur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se shkelë Ligjin për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 1;6;7;59;60;69;70; Rregulloren për prokurim publik nr.001/2022 nenet: 38;40;40.2 dhe nenin 48 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën Administrative.

Rrjedhimisht, OE ankues pretendon se i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe gjithashtu pretendon se OE i rekomanduar nuk është i përgjegjshëm.

Pretendimi i parë i OE ankues kundër eliminimit të tyre nga AK:

Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, konsideron se AK-ja, në vendimin e goditur me këtë ankesë arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me diapozitivin e tij pasi që sa i përket pretendimit ankimor të parë, ka konsideruar se pretendimi ankimor i joni është pjesërisht i bazuar, por për komisionin vlerësues nuk ka qenë e pranueshme kjo dëshmi, pasi që nuk figuron emri i projektit.

Ky arsyetim sa i përket pretendimit të parë ankimor është qartazi në kundërshtim me dispozitivin e vendimit si dhe me dosjen e tenderit. Pasi që vet AK-ja ka konstatuar që pretendimi është pjesërisht i bazuar pasi që përmbushet kushti prej së paku 500 mijë Euro, ndërsa në dosjen e tenderit askund nuk ceket fakti që duhet te figuroj emri i projektit.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankues gjenden tri vërtetime bankare, në të cilat, vërtetimi bankarë i lëshuar nga RBKO është i pavlefshëm, për faktin se është për një projekt dhe aktivitet tjetër, ndërsa dy vërtetimet nga e njëjta bankë BKT të datës 06/12/2024 dhe 30/12/2024 të cilat vërtetojnë se OE posedon limit kreditor prej 500K dhe 660K, mirëpo nuk ceket se lëshohen si vërtetim për projektin në fjalë, siç është kërkuar nga AK në DT, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar, për faktin se mjetet nuk janë në llogari rrjedhëse si bilanc (mjete të gatshme) nga operatori ekonomik, por janë limit kreditor në nën llogari e cila nuk është e përcaktuar si vërtetim për projektin në fjalë.

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër GOE të rekomanduar:

Sa i përket pretendimit të dytë: AK-ja ka konstatuar se pretendimi jonë nuk është i bazuar, pasi që komisioni ka konstatuar se janë tre fajle me të njëjtin emër “Deklaratat e dorëzuara në ATK për tre vitet e fundit”, por shkarkimi nga formati ZIP e ka ruajtur vetëm njërin prej tyre për shkak të emërimit të njëjtë.

Ky konsatim i komisionit është qartazi i pabazuar dhe tendencioz, me të vetmin qëllim eliminimin e OE ankuese, pasi që Operatori Ekonomik H&B Consulting Sh.P.K, i ka bashkangjitur të tre këto deklarata tatimore në ATK dhe atë për vitin 2011-2022-2023, të kërkuara sipas kërkesës 1 të dosjes së tenderit dhe kjo vërtetohet edhe nga vet konstatimi i AK-së ku ka konstatuar se: Janë tre fajle me të njëjtin emër “Deklaratat e dorëzuara në ATK për tre vitet e fundit”, ndërsa pas shkarkimit të formatit ZIP e ka ruajtur vetëm njërin prej tyre për shkak të emërimit të njëjtë, pra në rastin konkret AK-ja është dashur që sipas neni 59.4 pika (i) apo (ii) të LPP-së, të sqaron këtë gabim teknik të bërë nga ana tyre.

Për më tepër pas shqyrtimit të dokumentacionit në kuadër të së drejtës sonë për qasje në dokumente, kemi vërejtur një shkelje të kërkesave të tenderit nga Operatori Ekonomik që është shpërblyer me kontratë.

Konkretisht, kemi konstatuar se mungojnë deklaratat tatimore për anëtarët e konsorciumit, përfshirë edhe liderin e tij.

Sipas kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit, është e detyrueshme që Operatori Ekonomik të dëshmojë qarkullimin vjetor për tre vitet e fundit (2021-2022-2023) me një vlerë jo më pak se pesë (5) milionë euro. Në rast të një grupi operatorësh ekonomikë, është përcaktuar se lideri i grupit duhet të kontribuojë me së paku 60% të qarkullimit të përgjithshëm.

Duke qenë se operatori i shpërblyer nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore për anëtarët e konsorciumit dhe liderin, ky fakt përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigje në pretendimi ankimor të OE ankues kundër GOE të rekomanduar:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjenden tri file të ngarkuar me të njëjtin emër “Deklaratat e dorëzuara në ATK për tre vitet e fundit”, mirëpo në momentin e hapjes nëse klikohet YES hapet qarkullimi i ATK-së për anëtarin e konsorciumit B-Bardhi dhe nëse klikohet NO hapet qarkullimi i ATK-së për liderin OE Linda SHPK, kjo rezulton si pasojë e ruajtjes së dokumenteve me të njëjtin emërim, ndërsa për anëtarin e tretë nuk posedon qarkullim të ATK-së, mirëpo bazuar në qarkullimet e liderit dhe të anëtarit të konsorciumit B-Bardhi, të njëjtit e mbulojnë vlerën e kërkuar nga AK, andaj konform rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 neni 26.5, i cili përcakton se gjendja ekonomike financiare dhe aftësitë teknike dhe ose profesionale aplikohen vetëm ndaj grupit në tërësi, dhe si e tillë, qarkullimi mbulohet si grup në tërësi nga Lideri i grupit mbi 60 % dhe nga anëtari tjetër i konsorciumit. Pretendimi i dytë i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar, për faktin se OE ankues nuk ka qenë në gjendje që ta hap dhe vërtetojë dokumentin e kontestuar, miëpo meqenëse nuk ndryshon gjendja fillestare, rekomandohet të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues

dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-185-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “H & B – Consulting” SH.P.K. të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor ku sipas NJK dhe DT është kërkuar tek kërkesat mbi mundësit e gjendjes financiare/ ekonomike për çka edhe është eliminuar OE ankues Kërkesa nr 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 500 mijë Euro, (Ne rast të grupit të OE, min. 60% të plotësohet nga lideri i grupit). **Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 2.** Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 500 mijë Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit). Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar, si kredi e pakushtezuar në emër të projektit, Paneli Shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues ku sqaron se, në ofertën e OE ankues gjenden tri vërtetime bankare, në të cilat, vërtetimi bankarë i lëshuar nga RBKO është i pavlefshëm, për faktin se është për një projekt dhe aktivitet tjetër, ndërsa dy vërtetimet nga e njëjta bankë BKT të datës 06/12/2024 dhe 30/12/2024 të cilat vërtetojnë se OE posedon limit kreditor prej 500K dhe 660K, mirëpo nuk çeket se lëshohen si vërtetim për projektin në fjalë, siç është kërkuar nga AK në DT, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar, për faktin se mjetet nuk janë në llogari rrjedhëse si bilanc (mjete të gatshme) nga operatori ekonomik, por janë limit kreditor në nën llogari e cila nuk është e përcaktuar si vërtetim për projektin në fjalë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për OE të rekomanduar për deklaratat tatimore , nga të gjeturat në këtë procedurë (sipas platformën e e-prokurimit) për vitin 2021,2022,2023 Lideri ka shumën prej 4,196,312.59 Euro, ndërsa si GOE ka vlerën në total prej 9,069,475.37 Euro.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështet raportin e ekspertit shqyrtues duke aprovuar si pjesërishtë ankesën e e OE ankues , ndërsa ka vendosur për të vërtetuar B58Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i QKMF në Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-185-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së

ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - H & B - Consulting SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: